REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 2023/1 Prot. Vlorë më, 04. 12. 2020

**VENDIM**

**Nr. 56, datë 04. 12. 2020**

**PËR**
**PAGESËN E ORËVE SUPLEMENTARE PËR SEKRETARITË MËSIMORE GJATË PROCESIT TË REGJISTRIMIT PËR VITIN 2020- 2021**

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr. 463 datë 16. 06. 2011 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24. 10. 2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore"*, si dhe referuar propozimit të Rektorit nr. 1965/ 1 prot, datë 27. 11. 2020, në mbledhjen e datës 04. 12. 2020 Bordi i Administrimit

**VENDOSI**

1. Të miratojë propozimin e ardhur me shkresën nr. 1965/1 prot, datë 27. 11. 2020 "Propozim për pagesën e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ", për punën e kryer jashtë orarit zyrtar dhe ditëve të pushimit gjatë procesit të regjistrimit për vitin akademik 2020- 2021.
2. Efektet e këtij vendimi janë 1,758,386 lekë dhe do të mbulohen nga buxheti i institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Bashkëlidhur këtij vendimi shkresa nr. 1965/1 prot, datë 27. 11. 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Dr. Ervis MOÇKA**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**REKTORI**

Nr. 1865/1 Prot. Vlorë më, 27. 11. 2020

**Lënda:** Përcjellje propozimi për pagesën e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ.

**KRYETARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT**
**Dr. ERVIS MOÇKA**

**KËTU**

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr. 1836/1 , datë 25. 11. 2020 "Për plotësim dokumentacioni të shkresës nr. 1836 prot, datë 09. 11. 2020 "Efekti financiar për orët e sekretareve" si dhe në mbështetje VKM nr. 463, datë 16. 06.2011 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24. 10. 2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore"* të ndryshuar, të Urdhërit të përbashkët nr. 4, datë 30. 09. 2020 "Për një ndryshim në urdhërin e përbashkët nr. 2, datë 02. 07. 2020 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit........" të QSHA dhe RASH, vendimit të Senatit Akademik nr. 78, datë 08. 09. 2020 të Senatit Akademik "Mbi miratimin e datës së fillimit të procedurës së regjistrimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve" urdhërit të Rektorit nr. 38, datë 31. 08. 2020 "Për orarin e punës së sekretarisë mësimore përgjat procesit të regjistrimeve për vitin akademik 2018- 2019", më lejoni t' Ju paraqes propozimin për kompesimin në vlerë monetare me shtesë, mbi pagën normale për orët shtesë dhe punën e kryer gjatë ditëve të pushimit dhe festave zyrtare për sekretaret mësimore. punë kjo e kryer gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve për vitin akademik 2019- 2020.

Marr shkas nga pozicioni dhe volumi i punës, me të cilin përballet sekretaria mësimore për shkak të fazës së regjistrimit, të pajisjes së studentëve me llogari elektronike për ndjekjen e mësimit online, përgatitjen e diplomave dhe pajisjen me to të studentëve të diplomuar si dhe ofrimin e shërbimeve të tjera ndaj studentëve, çmoj të arsyeshme se është e pamundur referuar VKM nr. 463 dhënia e ditëve të pushimit brenda 2 muajve nga kryerja e orëve shtesë.

Bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues lidhur me urdhërat e nxjerrë nga drejtuesit e njësive kryesore dhe efektet financiare të paraqitura dhe më parë pranë Bordit të Administrimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimi!

**REKTOR**

**Prof. Dr. ROLAND ZISI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTETESE

Nr.1836.... Prot                                                                 Vlorë, më 09.11.2020

**Lënda:** Efekti financiare për orët e sekretareve

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**KRYETAR DR.ERVIS MOÇKA**

**Për dijeni:** Administratores

Mirela Duka

I nderuar Z.Kryetar !

Referuar shkresave të përcjella nga Dekanët e Fakulteteve si më poshtë shënuar:

-Shkresa nr 1759 prot. datë 29.10.2020 "Procesi i regjistrimeve nga sekretaria e FE –së, për vitin akademik 2020-2021"

- Shkresës nr.1759/1 prot. datë 29.10.2020"Procesi i regjistrimeve nga sekretaria mësimore e FSHH për vitin akademik 2020-2021"

-Shkresës nr.1759/2 prot. datë 04.11.2020"Procesi i regjistrimeve nga sekretaria mësimore e FSH për vitin akademik 2020-2021"

- Shkresës nr.1759/3 prot. datë 06.11.2020"Procesi i regjistrimeve nga sekretaria mësimore e FSHT-së, për vitin akademik 2020-2021",

si dhe në zbatim të vkm-së 511 datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar.

Po ju percjell efektin financiar për orët shtesë të punës së sekretarive mësimore

| Nr. | Fakulteti | Orë totale të punuar jashtë orarit | Vlera bruto për orët jashtë orarit |
|---|---|---|---|
| 1 | Fakulteti i Shkencave Teknike | 1062.5 | 519,252 |
| 2 | Fakulteti Ekonomik | 850 | 420,002 |
| 3 | Fakulteti i Shkencave Humane | 1062.5 | 507,325 |
| 4 | Fakulteti i Shendetit | 637.5 | 311,807 |
| | *Totali* | *3612.5* | *1,758,386* |

Adresa /Adress: L. Pavarsia;
Bulevardi Vlorë-Skelë
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Universiteti Ismail Qemali
Fakulteti Ekonomik
Pagese ore jashte orarit per sekretaret viti 2020-2021

| Nr | Emer Mbiemer | paga bruto mujore | Ore shtese dite zakonshme pune | Ore shtese dite feste,shtune,diel | Paga/Ore | Vlera Bruto |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Anila Meli | 70,000 | 25.5 | 187 | 398 | 124,240 |
| 2 | Lorena Canga | 55,080 | 25.5 | 187 | 313 | 97,759 |
| 3 | Hatixhe Likaj | 56,760 | 25.5 | 187 | 323 | 100,741 |
| 4 | Razo Xhaferaj | 54,800 | 25.5 | 187 | 311 | 97,262 |
| | TOTALI | | 102 | 748 | | 420,002 |

Universiteti Ismail Qemali
FAKULTETI SHKENCAVE HUMANE
Pagese ore jashte orarit per sekretaret viti 2020-2021

| Nr | Emer Mbiemer | paga bruto mujore | Ore shtese dite zakonshme pune | Ore shtese dite feste,shtune,diel | Paga/Ore | Vlera Bruto |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SUELA BALILAJ | 66,080 | 25.5 | 187 | 375 | 117,283 |
| 2 | ARBANA KOKOSHI | 54,800 | 25.5 | 187 | 311 | 97,262 |
| 3 | ELVIONA XHYHERI | 54,800 | 25.5 | 187 | 311 | 97,262 |
| 4 | MATILDA JAZAJ | 55,360 | 25.5 | 187 | 315 | 98,256 |
| 5 | ANILA CANAJ | 54,800 | 25.5 | 187 | 311 | 97,262 |
| | TOTALI | | 127.5 | 935 | | 507,325 |

Universiteti Ismail Qemali
FAKULTETI SHKENCAVE TEKNIKE
Pagese ore jashte orarit per sekretaret viti 2020-2021

| Nr | Emer Mbiemer | paga bruto mujore | Ore shtese dite zakonshme pune | Ore shtese dite feste,shtune,diel | Paga/Ore | Vlera Bruto |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SILVANA SULSTAROVA | 70,000 | 25.5 | 187 | 398 | 124,240 |
| 2 | LIZA VERA | 58,440 | 25.5 | 187 | 332 | 103,723 |
| 3 | MIRANDA PAJO | 55,080 | 25.5 | 187 | 313 | 97,759 |
| 4 | JULIANA TAFILI | 54,240 | 25.5 | 187 | 308 | 96,268 |
| 5 | INILDA PETA | 54,800 | 25.5 | 187 | 311 | 97,262 |
| | TOTALI | | 127.5 | 935 | | 519,252 |

Universiteti Ismail Qemali
FAKULTETI SHENDETIT PUBLIK
Pagese ore jashte orarit per sekretaret viti 2020-2021

| Nr | Emer Mbiemer | paga bruto mujore | Ore shtese dite zakonshme pune | Ore shtese dite feste,shtune,diel | Paga/Ore | Vlera Bruto |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Belinda Dauti | 66,080 | 25.5 | 187 | 375 | 117283 |
| 2 | Nertila Kreshpaj | 54,800 | 25.5 | 187 | 311 | 97262 |
| 3 | Florida Ymeraj | 54,800 | 25.5 | 187 | 311 | 97262 |
| | TOTALI | | 76.5 | 561 | | 311,807 |

Vo: Nje sekretare ka punuar:

51 dite me nga 30 minuta e konvertuar ne ore jane 25.5 ore

21 dite me 8ore e 30 minuta te shtuana te diela , e konvertuar ne ore jane 178.5 ore

1 dite feste zyrtare me 8 ore e 30 minuta

Ne total kane punuar 433.5 ore ne dite te zakonshme dhe 3179 ore dite pushimi dhe feste

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE**
**DEKANI**

Nr. 302/1 Prot. Vlorë, më 04.09.2020

**URDHËR Nr. 06**
**Datë 04.09.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" , të Udhëzimit Nr. 17, datë 23.06.2020 për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019 për " Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e Ciklit të Parë të Studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të Ciklit të Dytë të Studimeve, në IAL", të Urdhërit të Përbashkët Nr.02, datë 02.07.2020 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e Ciklit të Parë të studimeve, në programet me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në IAL për vitin akademik 2020-2021", si dhe në Urhdërin e Përbashkët Nr. 04, datë 30.09.2020 për një ndryshim në Urdhërin të Përbashkët Nr.02, datë 02.07.2020, si dhe në zbatim të Urdhërit të Rektorit Nr. 38, datë 31.08.2020 "Për orarin e punës së sekretarisë mësimore përgjate procesit të regjistrimeve për vitin akademik 2020-2021"

**URDHËROJ:**

Sekretaret e Fakultetit të Shkencave Teknike, të punojnë sipas ditëve dhe orarit të përcaktuar në udhëzimet e mësipërme si dhe në udhëzimet që mund të vijnë në vazhdim nga MAS.

**Dekani**
**Prof.Asoc. Hajdar KIÇAJ**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlorë-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEKANI**

Nr. 238 prot.  Vlorë, më 03.11.2020

Lënda: Procesi i regjistrimeve nga sekretaria mësimore e FSH për vitin akademik 2020-2021

**UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**REKTORIT TË UNIVERSITETIT**
Prof.Dr.Roland Zisi

I nderuar Zoti Rektor,

Referuar, **Urdhër i përbashkët nr. 2 datë 02.07.2020** "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë,

**Urdhër i përbashkët nr. 3, datë 06.08.2020** " Për një ndryshim në urdhrin e përbashkët nr.2 datë 02.07.2020 për "Miratimin e kalendarit per procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional,në programet e integruara të ciklit të dytë.

**Urdhër i përbashkët nr.4, datë 30.09.2020** "Për një ndryshim në urdhrin e përbashkët nr.2, datë 02.07.2020 për "Miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2020-2021.

**Urdhërit të Rektorit nr.38, datë 31.08.2020**,"Për miratim e orarit të punës së sekretarisë mësimore përgjatë procesit të regjistrimeve për vitin akademik 2020-2021.

**Vendimit të senatit nr 78, datë 08.09.2020**,"Për miratimin e datës së fillimit të procesit të regjistrimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve

Adresa /Address: Blv.Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax +355533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Vlorë më, 05. 11.2020

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektorati
- Rektori
  - **Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal**
  - **Sektori Juridik**
  - **Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore**
    - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
    - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
    - Sektori i IT-së
- **Bordi i Administrimit**
- **Administrator**
  - **Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse**
    - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
    - Sektori i Prokurimeve
    - Sektori i Shërbimeve
  - **Njësia e Auditit të Brendshëm**
- **Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional**
  - **Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve**
    - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
    - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
  - **Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik**
- **Zv. Rektor Akademik**
  - **Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë**
    - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
    - Sektori i Këshillimit të Karierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
  - **Sektori i Bibliotekes Shkencore**

| | |
|---|---|
| ➢ **Prof. Asoc. Aurela Saliaj** | **Dekan F.SH.** |
| • Kryesekretare | F.SH. |
| ➢ **Prof. Dr. Albert Qarri** | **Dekan F.E** |
| • Kryesekretare | F.E |
| ➢ **Prof. As. Armela Panajoti** | **Dekan F.SH.H** |
| • Kryesekretare | F.SH.H |
| ➢ **Prof.As. Hajdar Kicaj** | **Dekan F.SH.T.N** |
| • Kryesekretare | F.SH.T.N |

**REKTORI**
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax : +3552222288



Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Vlorë më, 30. 10. 2020

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim te legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektor
  - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
  - Sektori Juridik
  - **Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore**
  - Sektori i Burimeve Njerëore dhe Protokoll-Arkivës
  - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
  - Sektori i IT- së
- **Bordi i Administrimit**
- **Administrator**
  - **Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse**
  - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
  - Sektori i Prokurimeve
  - Sektori i Shërbimeve
- **Njësia e Auditit të Brendshëm**
- **Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional**
  - **Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve**
  - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
  - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
  - **Sektori i Promovimit Akademik dhe Kërkimeve Shkencore**
- **Zv. Rektor Akademik**
  - **Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë**
  - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
  - Sektori i Këshillimit të Karierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
  - **Sektori i Bibliotekës Shkencore**

- **Prof. Asoc. Aurela Saliaj** — **Dekan F.Sh.P**
  Kryesekretare — F.Sh.P
- **Prof. Dr. Albert Qarri** — **Dekan F.E**
  Kryesekretare — F.E
- **Prof. Asoc. Armela Panajoti** — **Dekan F.Sh.H**
  Kryesekretare — F.Sh.H
- **Prof.Asoc. Hajdar Kicaj** — **Dekan F.Sh.T**
  Kryesekretare — F.Sh.T

**REKTOR**
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel, Fax ++35533222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

REKTORI

Nr. 1310 Prot. Vlorë, më 31.08.2020

**URDHËR**

Nr.32, datë 31.08.2020

**PËR**

**ORARIN E PUNËS SË SEKRETARISË MËSIMORE PËRGJATË PROCESIT TË REGJISTRIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2018- 2019"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Urdhërin e Përbashkët nr. 2, datë 02. 07. 2020 të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar *"Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve , në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020- 2021"*

URDHËROJ:

1. Të miratojë, daljen në punë të sekretarive mësimore në orarin [illegible] , në zbatim të Urdhërit të përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 2, datë 02. 07. 2020.
2. Sekretaritë mësimore të vazhdojnë regjistrimet edhe nëse do të kenë raste edhe pas këtij orari.
3. Zëvendës Rektori Akademik dhe Dekanët do të monitorojnë gjithë procesin e regjistrimeve përgjatë orarit $08^{00}$- $16^{30}$ .
4. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri Zëvendës Rektori Akademik, Dekanët e Fakulteteve si dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore.

**REKTOR**

**Prof. Dr. Roland Zisi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 2580/1 Prot. | Tiranë, më 30.09.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 2046/1 Prot. | Tiranë, më 30.09.2020

## URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 4, Datë 30/09/2020

## PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 2, DATË 02.07.2020 "PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 03.06.2020, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim" dhe të udhëzimit nr. 10, datë 15.05.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar,

## URDHËROJMË

| | | | |
|---|---|---|---|
| 31 | Kreu IV/4, pika 16 | 16.12.2020 | 29.12.2020 |
| 32 | Kreu IV/5, pika 1 | 06.09.2020 ÷ 19.09.2020 | 22.10.2020 ÷ 04.11.2020 |
| 33 | Kreu IV/5, pika 18 | 20.09.2020 | 06.11.2020 |
| 34 | Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 1 | 30.09.2020 | 10.11.2020 |
| 35 | Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 2 | 01.10.2020 | 11.11.2020 |
| 36 | Kreu IV/5, pika 21 | 10.10.2020 | 13.11.2020 |
| 37 | Kreu IV/5, pika 22, fjalia 1 | 10.10.2020 ÷ 14.10.2020 | 16.11.2020 ÷ 20.11.2020 |
| 38 | Kreu IV/5, pika 22, fjalia 2 | 18.10.2020 | 23.11.2020 |
| 39 | Kreu IV/5, pika 23 | 16.12.2020 | 29.12.2020 |
| 40 | Kreu IV/6, pika 1 | 11.10.2020 (E vlefshme për IAL-të publike)<br>18.10.2020 (E vlefshme për IAL-të jopublike) | 06.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike dhe jopublike) |
| 41 | Kreu IV/6, pika 2 | 22.10.2020 (E vlefshme për IAL-të publike)<br>29.10.2020 (E vlefshme për IAL-të jopublike) | 14.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike dhe jopublike) |
| 42 | Kreu IV/6, pika 4 | 06.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike)<br>03.11.2020 (E vlefshme për IAL-të jopublike) | 16.11.2020-26.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike dhe jopublike) |
| 43 | Kreu IV/6, pika 16 | 16.12.2020 | 29.12.2020 |

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, si dhe IAL publike dhe jopublike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Drejtore e Përgjithshme

Znj. Rezana VRAPI

Për Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtori i Përgjithshëm

Z. Arjan XHELAJ

Nr. 4505 Prot.

Dt. 28.09.2020

RASH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE "RRJETI AKADEMIK SHQIPTAR"

Nr. Prot. 20-179

Tiranë, më 29.09.2020

**Lënda :** Mbi shtyrjen e periudhës së aplikimeve dhe regjistrimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve dhe për transferimin e studimeve

Drejtuar: Prof. Dr. Roland Zisi, Rektor

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

I nderuar Z. Rektor,

Në vijim të kërkesës Tuaj drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë mbi shtyrjen e periudhës së aplikimeve dhe regjistrimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve dhe për transferimin e studimeve, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 dhe shtyrjes së sezonit të provimeve deri në fund të muajit Tetor MASR i është drejtuar Qendres RASH me kërkesën Nr. 4900 Prot. datë 15.09.2020.

Bazuar në kërkesën sa më sipër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë lutemi të konsultoni Udhëzimin e Përbashkët RASH-QSHA Nr.2 datë 02.07.2020, Shtojca Nr.10, Ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.3 datë 06.08.2020 dhe të na përcillni brenda datës 5 Tetor sugjerimet Tuaja mbi datat e reja të aplikimeve dhe regjistrimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve dhe për transferimin e studimeve me qëllim rishikimin e Udhëzimit të Përbashkët RASH-QSHA konform kërkesës Tuaj.

Në pritje të sugjerimeve Tuaja,
Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR I BORDIT DREJTUES
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

DR. ING. ARJAN XHELAJ

Adresa: Rr. Durrësit, Nr.219, 1001 Tiranë

Email: [illegible]

| | | | |
|---|---|---|---|
| 31 | Kreu IV/4, pika 16 | 16.12.2020 | 29.12.2020 |
| 32 | Kreu IV/5, pika 1 | 06.09.2020 - 19.09.2020 | 22.10.2020 - 04.11.2020 |
| 33 | Kreu IV/5, pika 18 | 20.09.2020 | 06.11.2020 |
| 34 | Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 1 | 30.09.2020 | 10.11.2020 |
| 35 | Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 2 | 01.10.2020 | 11.11.2020 |
| 36 | Kreu IV/5, pika 21 | 10.10.2020 | 13.11.2020 |
| 37 | Kreu IV/5, pika 22, fjalia 1 | 10.10.2020 - 14.10.2020 | 16.11.2020 - 20.11.2020 |
| 38 | Kreu IV/5, pika 22, fjalia 2 | 18.10.2020 | 25.11.2020 |
| 39 | Kreu IV/5, pika 23 | 16.12.2020 | 29.12.2020 |
| 40 | Kreu IV/6, pika 1 | 11.10.2020 (E vlefshme për IAL-të publike)<br>18.10.2020 (E vlefshme për IAL-të jopublike) | 06.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike dhe jopublike) |
| 41 | Kreu IV/6, pika 2 | 22.10.2020 (E vlefshme për IAL-të publike)<br>29.10.2020 (E vlefshme për IAL-të jopublike) | 14.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike dhe jopublike) |
| 42 | Kreu IV/6, pika 4 | 06.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike)<br>03.11.2020 (E vlefshme për IAL-të jopublike) | 16.11.2020-26.11.2020 (E vlefshme për IAL-të publike dhe jopublike) |
| 45 | Kreu IV/6, pika 16 | 16.12.2020 | 29.12.2020 |

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, si dhe IAL publike dhe jopublike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Drejtore e Përgjithshme

Znj. Rezana VRAPI

Për Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtori i Përgjithshëm

Z. Arjan XHELAJ

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM

Nr.463, datë 16.6.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, shkronja "c", 20, shkronjat "ç", "ë" e "g", dhe 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" dhe të neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I "Kohëzgjatja e punës" bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohet të kryejë orë shtesë.

Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.

Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari operacionale, orët shtesë në punë, si rregull, i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.

Titullari i institucionit detyrohet t'ia japë kërkuesit këtë pushim, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë.

Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale. Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar, në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page, ndërsa orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22:00-6:00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind shtesë të kësaj page.

Rregullat mbi procedurën e kryerjes së pagesës së orëve shtesë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.".

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

"6. Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, mund të kryejë veprimtari mësimdhënieje pas miratimit nga titullari i institucionit, por jo më shumë se 4 (katër) orë në javë, të cilat kompensohen në orë pune, brenda javës, pas orarit zyrtar të punës. Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që angazhohet në mësimdhënieje, detyrohet të depozitojë pranë sektorit të burimeve njerëzore kopjen e kontratës së lidhur me institucionin arsimor.".

2. Në kreun II "Pushimet" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 2 shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

"Ditët e festave zyrtare nuk duhet të përfshihen në pushimet vjetore të paguara. Nëse nëpunësit

të administratës publike dita e festës i bie në periudhën e pushimeve vjetore të paguara, këto të fundit i shtyhen për aq ditë sa ka qenë festa zyrtare.

Rregullat për procedurën e kryerjes së lejes së zakonshme në periudha të ndryshme e të ndara përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.".

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pushimet vjetore nuk mund të kompensohen me pagesë, përveç rastit kur është zgjidhur marrëdhënia e punës. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, do të jetë e pavlefshme.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

# Kalendari i festave zyrtare për vitin 2020

Bankat janë të mbyllura ditëve të shtuna dhe të diela si dhe në ditët e festave zyrtare në vijim.

| | |
|---|---|
| 01 janar 2020 | Festat e Vitit të Ri |
| 02 janar 2020 | Festat e Vitit të Ri |
| 03 janar 2020 | Pushim zyrtar*** |
| 14 mars 2020 | Dita e Verës* |
| 22 mars 2020 | Dita e Nevruzit* |
| 12 prill 2020 | E diela e Pashkëve Katolike* |